



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së dhjetë të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më 28.12.2022, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Nora Kelmendi (LVV), Arbër Vokri (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Ermal Osmani (LVV), Feim Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Rashit Gashi (LVV), Petrit Reçica (LVV), Mirsad Vitija (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Violeta Salihu (LVV), Tiera Kasumi-Berisha (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Radie Hoxhaj, (LVV), Berna Saraçi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Fehmi Kupina (LDK), Sami Salihu (LDK), Pëllumb Bajqinovci (LDK), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Amir Simnica (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Granit Geci (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Liridon Selmani, (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Fatmir Dervishi, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Gresa Lahu (PDK), Endrit Gashi (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), Endrit Zabërgja, (NISMA) dhe Agim Kuleta (LB).

Munguan: Berat Lahu (LVV), Bahri Gashi (AAK) dhe Kushtrim Mushica (AAK).

Të pranishëm ishin edhe: Përparim Rama, kryetar i Komunës, Alban Zogaj, nënkryetar i Komunës, Donjeta Sahatçiu, nënkryetare e Komunës, Bersant Beka, drejtor i Drejtorisë së Administratës, Donat Lushaku, drejtor i Drejtorisë së Kadastrit, Mimoza Sylejmani, drejtore e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Arbër Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Ilirik Musliu, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Adelina Sahiti, drejtore e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Granit Rugova, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Besianë Musmurati, drejtore e Drejtorisë së Arsimit, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Doruntinë Maloku, drejtore e Drejtorisë së Pronës, Plator Gërdovci, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Krenar Xhaferi, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve dhe përfaqësues të medieve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Fehmi Kupina**, kryesues i Kuvendit.

Para se të fillonin me diskutimin e pikave të rendit të ditës, kryesuesi i njoftoi të pranishmit se në përbërjen e GP të LVV-së në Kuvendin komunal është bërë një ndryshim, pasi që znj. Rita Zeqiri për arsye personale, ka dhënë dorëheqje nga pozita e këshilltarit komunal, kështu që atë e zëvendëson asamblistja e radhës nga radhët e GP të LVV-së, znj. Radie Hoxhaj.
Radie Hoxhaj e bëri betimin para Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për rendin e ditës.

Arianit Beqiri, propozoi që në rend të ditës të futet pika: "Diskutim për ndërmarrjen "Prishtina Parking"", me arsyetimin se themelimi i kësaj ndërmarrje në Prishtinë është prit dhe është menduar si zgjidhje e problemeve dhe gjë që nuk ka rezultuar kështu për shkak se këtë vit jemi dëshmitarë të protestave të qytetarëve në disa lagje të qytetit rreth problemeve me formën e pagesave, mënyrës së kundërligjshme të dënimeve, punës duke anashkaluar rregulloren etj.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e dhënë nga z. Beqiri.

Kryesuesi konstatoi se më 16 vota për, 25 kundër dhe 1 abstenim, nuk futet në rend të ditës: "Diskutimi për ndërmarrjen "Prishtina Parking"".

Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim, u miratua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së nëntë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit;
2. Raporti i punës së Kryetarit, për periudhën 7 dhjetor 2021 - 7 dhjetor 2022;
3. Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit për themelimin e komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-020/02-103516/22, më 12.05.2022;
4. Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit për hapjen e kodit buxhetor, nr. 01-400/01-177472/22, dt. 26.07.2022;
5. Propozimvendimi për miratimin e Projektregullores për orarin e punës dhe mbrojtjen nga ndotja akustike në sektorin e gastronomisë;
6. Propozimvendimi për miratimin e Projektregullores për transparencë;
7. Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit për caktimin e komisioneve për rekrutim të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese në kryeqytetin e Republikës së Kosovës, nr. 01-151/01-151637/22, të dt. 30.06.2022;
8. Propozimvendimi për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2023;

9. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Arif Dermishit;
10. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Shukrije Bajgorës, Muhamed Sadikut, Adnan Sadikut dhe "Vëllezërit Asllani" SHPK;
11. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për ndërtimin e objektit të Odave të Profesionistëve Shëndetësorë;
12. Propozimvendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2023;
13. Informatë lidhur me Raportin vjetor të komisionit të aksionarëve të NPL "Trafiku Urban", SHA, Prishtinë;
14. Informatë rreth mbjelljeve vjeshtore;
15. Informatë nga Drejtoria e Kulturës;
16. Pyetje dhe përgjigje;
17. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së nëntë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit

Gëzim Sveçla bëri vërejtje rreth "Vendimit lulëkuqja me katër petale të bëhet simbol unik përkujtimorë i gjenocidit në Kosovë", duke thënë se atë që e kemi votuar ne si mbështetje, është i përpiluar si vendim dhe sot gjysma e administratës së Kosovës po merret me këtë vendim dhe pasojat eventuale që mund t'i ketë ai vendim, është se mund të krijojë një precedent për komunat e tjera, që mund të marrin vendime të tilla e që shkojnë në dëm të interesit të vendit. Prandaj, duhet të jeni shumë të kujdesshëm në këtë raport. Është shumë e qartë mënyra se si përpilohen dhe merren vendimet dhe është për çdo kritikë një veprim i tillë.

Me vërejtjen e dhënë, kryesuesi konstatoi se më 26 vota për dhe 1 abstenim, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së nëntë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit.

Pika e dytë

Raporti i punës së Kryetarit, për periudhën 7 dhjetor 2021 - 7 dhjetor 2022.

Lidhur me Raportin e punës së kryetarit, për periudhën 7 dhjetor 2021 - 7 dhjetor 2022, për të arriturat dhe punët që janë bërë nga kryetari brenda kësaj periudhe kohor, të pranishmit i informoi Përparim Rama, kryetar.

Gëzim Sveçla tha se mënyra, forma dhe qasja me të cilën është shkruar ky raport, është për çdo kritikë dhe lë shumë për të dëshiruar Duke filluar nga përmbajtja, pasaktësitë e shumta që përmban e deri tek gabimet teknike, që janë krejt të papranueshme për një raport të punëve të kryera në qendrën më të madhe ekonomike dhe politike të vendit, në Kryeqytetin e Republikës. Me këtë raport shumë amatoresk e me shumë të pavërteta brenda tij, me shumë kamuflime e arsytetime koti, ofendohet pamasë qytetari i Prishtinës. Zotëri Rama as nuk i ka përmbushur 30 premtime, e as nuk i ka gjysmë të përmbushura 24 të tjera, e sa për projekte të iniciuara, as që ia vlen të diskutohet.

Ai tha se është premtuar lirimi nga pagesa e shfrytëzimit të transportit publik për nxënësit, pensionistët dhe shtresat e ndryshme sociale, pra për punët që i keni premtuar, por që mbetën vetëm premtime. Për 12 muaj nuk prodhuat as stabilitet e as seriozitet, as zhvillim e as përparim, as rregull, as ligjshmëri, në vend të kësaj qytetarëve u servuat dëshpërim, stagnim, vështirësi, bërlllok, gropa, errësirë, kolona komunikacioni etj. Keni bërë punësime partiake nëpër drejtori e ndërmarrje publike komunale, vendime të paligjshme në secilën seancë etj. Është koha z. kryetar, të japësh zgjidhje, ose fillo puno e realizoje atë çfarë iu ke premtuar, ose mos i zgjat vuajtjet e tyre.

Jeta Rafuna theksoi se ky raport përfshin periudhën 7 dhjetor 2021 - 7 dhjetor 2022, e këtë praktikë të llogaridhënies dhe transparencës para qytetarëve po e krijon kryetari Rama dhe qeverisja e LDK në Prishtinë.

Nga gjithsej 205 premtime, 30 premtime janë përmbushur, 24 premtime janë gjysmë të përmbushura, 3 premtime pjesërisht të përmbushura dhe 110 premtime të filluara. Të gjitha këto kryetari Rama ka arritur t'i bëjë vetëm në një vit qeverisje, duke u ballafaquar me shumë probleme të trashëguara, e sidomos me një buxhet krejtësisht të paplanifikuar mirë. Kryetari dhe drejtoritë kanë bërë punë të mira në të gjitha dikasteret.

Me këtë energji, vullnet dhe dinamikë të punëve të kryetarit dhe ekipit të tij, Prishtina do të transformohet në kryeqytet unik në botë dhe këtë qytetarët e Prishtinës po e shohin çdo ditë.

Leutrim Retkoceri tha se ky raportim i kryetarit është i bazuar edhe në Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe në Rregulloren e Kuvendit të Komunës së Prishtinës. Raportimi për punën mendoj se e ka një dallim mes raportimit për punën dhe raportimit mbi premtimet 4-vjeçare, në 1-vjeçarin e punës në qeverisjen në Komunën e Prishtinës.

Besoj se duhet të merren parasysh edhe disa argumente shtesë të cilat u thanë. Ne si GP i kemi adresuar qysh në fillim të kësaj legjislature problemet, mangësitë, dobësitë dhe mundësitë që i ka kryeqyteti, që njëra nga to është edhe një buxhet i vitit 2021, ky buxhet është më se përcaktues për zhvillimet edhe kontratat që ia jep qeverisjes lokale në këtë rast edhe Komunës së Prishtinës. Njëra nga shkaqet e mos realizimit të kontratave ka qenë edhe bllokimi i organit shqyrtues të prokurimit, pra mos ekzekutimi i investimeve kapitale që rrjedh nga argumenti i mësipërm. Këto janë sfida që mendoj se janë adresuar në buxhetin e

vitit 2023. Sa i përket qeverisjes dhe energjisë me të cilën shihen, vërehet se ka ndryshim dhe ky ndryshim është më i madh në intensitet sesa në dy vitet e kaluara të qeverisjes.

Uroj që viti 2023 të jetë një vit i suksesshëm, shumë më i suksesshëm sesa ky që po e lëmë pas! Besoj dhe jam i bindur në këtë.

Sami Boroci tha se ky raport është mirë i përgatitur, por mendoj që ka mundur me qenë ndoshta ende më i detajuar, të përmbajë pak më shumë afate, kur planifikohet të përfundohen shumë çështje që janë veç si të iniciuara, sepse nëse e shohim raportin, shumica e temave janë të iniciuara, kështu kuptohet se nuk mundesh në vitin e parë me mbërri me iniciuar dhe realizuar, sidomos kur kemi parasysh procedurat e prokurimit dhe gjëra të ngjashme, mirëpo ka shumë tema që d.m.th. veç i shohim si të iniciuara, por që nuk kanë një ide se kur mund të përfundojnë ose diçka të ngjashme. Nëse e shohim buxhetin tek investimet kapitale, kemi shumë pak realizim të buxhetit, por kryetari duhet ta ketë parasysh që në vitin e dytë e tutje të ketë sa më shumë hapësira për planifikim, të bëhen studime të nevojshme, kështu që edhe qytetarët edhe ne, presim që këto projekte të fillojnë të realizohen, sepse në vitin e dytë secili prej nesh mund të gjykojë saktë qeverisjen tuaj dhe të drejtorëve tuaj.

Shpresoj që viti 2023 do të jetë një vit që ju dhe qeverisja juaj do t'i realizoni zotimet dhe premtimet e juaja.

Endrit Zabërgja tha se mënyra e përpilimit të raportit është e pasinqertë, dhe si i tillë meriton të kritikohet, sepse besoj se po orvatemi drejt një lajthitje se kinse në Prishtinë paska filluar i tërë programi zgjedhor për një vit, me vetëm 38 premtime të pafilluara. Në bazë të këtij raporti shihet si problem se si po i llogaritni punët e kryera, tendencën për të hiperbolizuar punët dhe propaganda se gjoja premtimet po realizohen. Realizimi i premtive që është dhënë nga ju nuk janë trajtuar ashtu si duhet, ku prej shumë premtimeve të dhëna, në veçanti për rininë, nuk janë realizuar, kështu që nuk ju ka krijuar hapësira punuese të rinjve, laboratorë fabrikues, e pastaj mbështetje financiare për të rinjtë që përfshihen me ide kreative. Uroj që për vitin tjetër, që të mos na ofendohet përsëri intelijenca me raporte të tilla!

Berna Saraçi, lidhur me raportin e prezantuar nga kryetari ngriti shqetësim, duke thënë se ku është racionaliteti juaj nëse në këtë raport na ofroni premtime, të cilat i keni me status si të përmbushura, ndërsa janë të formuluar në këtë mënyrë shumë premtime të dhëna dhe pak të realizuara. Po ashtu, në këtë raport vërehen gabimet drejtshkrimore dhe substanciale, në fakt të fjalëve që ofrohen e që ia ulin krejtësisht seriozitetin raportit.

Arianit Beqiri tha se ky raport ka mekanizma të zbutë ose rritë hendekun e pabarazisë sociale. Komuna ka mundësi që të baraspeshojë cilësinë e jetës nëse ajo është komunë me shumicë, lagjja duhet të jetë hapësira në të cilën zhvillohet jeta.

Kryetari mund të flasë çfarë të dojë për raportin 1-vjeçar, mund të prezantojë fakte e pika të cilat mendoni se i keni realizuar, por nëse do të gjykonit objektivisht, nuk do të thoni se jeta në qytet është përmirësuar. Ne për një vit në opozitë kemi dëshmuar se jemi konstruktiv dhe se nuk pengojmë, duke bërë opozitën vetëm për hire të opozitës, mirëpo kjo nga ana juaj është keqpërdorur vazhdimisht.

Rashit Gashi tha se ky raport është zhgënjyes, posaçërisht lidhur me ujësjellësin në zonën e Gollakut. Disa prej aktiviteteve të organizuara ka qenë Festivali Ndërkombëtar i Valleve, ku kanë marrë pjesë nga Argjentina e lartë, nga Kameruni etj., e që nuk e keni raportuar, pavarësisht që e keni përkrahur në mënyrë simbolike këtë aktivitet.

Hafiz Krasniqi e mbështeti raportin, duke shprehur mendimin se kur në Kosovë shihet që optimizmi ka rënë në zero, kryetari Rama në Prishtinë e ka kthyer një optimizëm edhe për punë, edhe për jetë, prandaj ju përgëzoj zotëri kryetar juve dhe ekipin tuaj.

Driton Rukiqi falënderoi kryetarin për raportin e prezantuar, duke thënë se nga qytetarët e ke marrë besimin dhe atë besim je duke e kthyer me punën tuaj çdo ditë, bashkë me ekipin tuaj.

Donjeta Dragusha theksoi se përveç punëve që janë kryer, ne po flasim për 1 vit qeverisje dhe ajo që mendoj se është më e mira që ka bërë kryetari Rama gjatë këtij viti, është planifikimi shumë i mirë dhe i detajuar i të gjitha projekteve dhe planeve të tij.

Amir Simnica falënderoi kryetarin për raportin e prezantuar, duke thënë se kjo qeverisje, konkretisht në lagjen time, po e vazhdon punën aty ku e ka lënë LDK-ja në vitin 2013, ku për tetë vjet nuk është bërë asgjë. Të falënderoj për vullnetin dhe gatishmërinë që po tregon për çdo projekt në Prishtinë.

Alban Zogaj, nënkryetar, theksoi se pavarësisht që u quajt fjalim i gjatë, konsideroj që është fjalim i punës njëvjeçare, me një dinamik të jashtëzakonshme, andaj kritikën të cilat u dhanë nga parafolësi mendoj se nuk qëndrojnë, janë tendencioze dhe të pabaza. Nuk mund ta pranoj me u quajt zi e më zi puna 1-vjeçare e mandatit tonë të parë, është tendencë, është kritikë e pabazuar, sepse Prishtina nuk është sot zi e më zi, por është bardhë e më bardhë dhe kur bëjmë vlerësim edhe në shkollë dhe kudo, vlerësimi zakonisht bëhet mbi shkallën e krahasimit.

Ajet Brajshori lidhur me raportin e prezantuar, tha se i respektoj edhe mendimet e moderuara dhe mendimet të cilat kanë bazë, mendimet të cilat kanë fakte, por nuk mund të pajtohem me ato të cilat janë më shumë tendencioze, andaj mendoj që jemi në një shoqëri që duhet t'i kuptojmë drejt proceset, drejt rezultatet dhe ta bëjmë vlerësimin objektiv.

Për të bërë një vlerësim objektiv duhet të kemi një performancë pozitive, duke pasur parasysh planifikimin, afatet kohore, kriteret, treguesit dhe faktet. Prandaj, i nderuari kryetar, na i ke ofruar faktet dhe përtej asaj që ne i kemi ditur vetë dhe e ke shtrirë ende lëvizjen drejt zhvillimit të qytetit edhe me projekte të tjera të cilat nuk i ke pasur në programin tuaj. Kjo për mua flet për një vizion të qartë, për një udhëheqës jo një mandat por edhe me shumë mandate.

Fiknete Bejta e falënderoi ekipin e kryetarit Rama për punën që kanë bërë brenda kësaj periudhe kohore. Unë nuk e shoh jetën në qytetin e Prishtinës zi e ma zi ose me ngjyra bardh e zi, sepse këtë vit është në hapa të sigurt ndërtimi i Spitalit të qytetit, i përfolur tash e 10 vjet. Gjatë këtij viti kanë filluar të ndërtohen 9 shkolla në Prishtinë, që zgjidh një problem të madh të disa lagjeve të qytetit, duke përfshirë këtu edhe lagjen "Sofalia" që kanë bërë kërkesë, për 12 vjet përsërisin një kërkesë të tillë. Nuk është zi e më zi krijimi i Klinikës Stomatologjike, e shumë e shumë projekte të tjera, kështu që shumë zotime janë përmbushur, disa kanë filluar, disa janë gjysmë të përmbushura, andaj mendoj se kjo duhet të përshëndetet dhe të falënderohet kryetari Rama për punën e bërë.

U konstatua se u përkrah Raporti i punës së Kryetarit, për periudhën 7 dhjetor 2021 - 7 dhjetor 2022.

Pika e tretë

Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit për themelimin e komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-020/02-103516/22, më 12.05.2022.

Gëzim Sveçla bëri të ditur se për anëtar të këtij komiteti propozojnë Petrit Reçicën. Kryesuesi konstatoi se më 35 vota për dhe 4 abstenime, u miratua Vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit për themelimin e komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-020/02-103516/22, më 12.05.2022.

Pika e katërt

Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit për hapjen e kodit buxhetor, nr. 01-400/01-177472/22, dt. 26.07.2022

Arsyetimin për këtë propozimvendim e paraqiti Valbona Makolli, drejtore. Sami Salihu tha se ky vendim është më se i mirëseardhur si për fermerët e komunës së Prishtinës, ashtu edhe për ne si GP, andaj e përkrahim për miratim. Leutrim Retkoceritha theksoi se ky vendim do të ndikojë drejtpërdrejt në performancën edhe të rritjes së vlerës së bujqësisë në komunën tonë, andaj si GP e përkrahim për miratim.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 44 vota për u miratua Vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit për hapjen e kodit buxhetor, nr. 01-400/01-177472/22, dt. 26.07.2022

Pika e pestë

Propozimvendimi për miratimin e Projektregullores për orarin e punës dhe mbrojtjen nga ndotja akustike në sektorin e gastronomisë

Faqe7nga18

Lidhur me këtë propozimvendim të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Ilirik Musliu, drejtor.

Gëzim Sveçla tha se kjo është një rregullore shumë e nevojshme, që ka impakt drejtpërdrejt në jetën e banorëve të Prishtinës, por edhe në një sektor shumë të rëndësishëm për ekonominë e kryeqytetit, për gastronominë, andaj mbetet që Inspeksioni komunal që është kompetent për këtë çështje, t'i zbatojë kriteret e njëjta për rastet identike. Lidhur me këtë, rreth mënyrës së pajisjes së certifikatave të cilësisë për pajisje të kontraktuara, si dhe çmimit të tyre, e që mendoj se ky çmim është i ndryshëm nga çmimi i cili do ta paguajnë gastronomet, kërkoj të dijë se si ka ndodhur kjo.

Pëllumb Bajçinovci tha se me anën e kësaj rregulloreje do të bëjmë kategorizimin e lokaleve, në bazë të të cilit do të aplikojmë rregulla të ndryshme për kategori të ndryshme.

Përcaktimi i orarit të punës dhe i ndotjes akustike, po ashtu do të përcaktohen zonat strategjike për zhvillimin e gastronomisë në katër lagjet më të mëdha të kryeqytetit.

Gjithashtu në bashkëpunim me lokalet do të sigurohemi që zhvillimi i gastronomisë në këto zona të mos e pengojë jetesën për qytetar në atë pjesë, andaj nevoja urgjente e rregullimit të bashkëjetesës në mes të komunitetit dhe biznesit dhe gastronomisë në lagjet e kryeqytetit, do e sjell një rregullore e cila sigurisht se nuk i plotëson dëshirat e të gjithëve, mirëpo do të krijojë rregull dhe ligj dhe do të jetë e njëjtë për të gjithë, pa përjashtime.

Leutrim Retkoceri falënderoi kryetarin për një inkurajim të zgjidhjes së kësaj problematike, gjithashtu ekipit që ka punuar, e në veçanti falënderim për nënkryetaren, Donjeta Sahatçiu, dhe drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, z. Ilirik Musliu, të cilët në një format tjetër e kanë dizajnuar këtë rregullore, që ka qenë jashtëzakonisht transparente, takim me qytetarët dhe në fund janë të kënaqur të gjitha palët që janë pjesë e saj.

Sami Boroci tha se ne më në fund e kemi para vetes një rregullore, që besoj se do të rregullojë bashkëjetesën e një komuniteti shumë të madh e të fuqishëm në Prishtinë, por mendoj se sfida do të mbetet zbatimi i saj.

Ai propozoi që në një të ardhme të afërt, nëse Komuna ka hapësirë, të ndajë një fond të caktuar për ti mbështetur këto lokale të gastronomisë për izolim në akustikë, besoj se kishte qenë e mirëseardhur dhe e kishte bërë shumë më të lehtë zbatimin e saj.

Endrit Zabërgja tha se kjo rregullore në vetvete është mjaft e mirë dhe që meriton mbështetje, kështu që puna me dëgjimet publike dhe grupet e interesit po dëshmon se ka dalë e suksesshme, pasi që të gjitha palët duket të jenë ndarë të kënaqur. Po ashtu, e përgëzoj drejtorin, Ilirikun, për prezantimin. Më së shumti po më pëlqen fakti që kjo pajisje është prodhim vendor dhe si i tillë më së miri e promovon mbështetjen e prodhimit vendor. Derisa shqetësimi im ka të bëjë me zbatimin e kësaj rregulloreje në tërësi, në kuptimin e asaj se më intereson të di se kush ka përgjegjësi për sigurinë kibernetike, në veçanti tek pjesa e Softwarit.

Hafiz Krasniqi shprehu mendimin se kjo është ndoshta njëra prej rregulloreve që më së shumti prek pozicionin e qytetarëve. Sa i përket disa termeve që janë theksuar në disa dispozitave të kësaj rregulloreje, konkretisht tek dispozitat ndëshkimore, aty ku thotë “Inspektoriati i kryeqytetit” dhe përderisa është në fuqi statuti i mëparshëm, atëherë duhet të jetë “Inspektoriati i Komunës së Prishtinës”. Në anën tjetër, e kemi edhe tek Komisionet, që konsideroj se ato duhet të jenë të bazuara në Statutin e Komunës, kështu që ky statut është i vitit 2010 dhe nuk ka bërë asnjë ndryshim deri më tani.

Petrit Reçica ngriti shqetësim rreth zhurmës së krijuar në disa vende, si ajo në “DFTHN” dhe “Termokiss”, aty nuk zhvillohet biznes, por bëjnë muzikë, kultivojnë bende të reja, por çka do të ndodhë me ato vende, kështu që mos t’i fusim edhe këto brenda kësaj rregulloreje, duhet shikuar mundësinë që edhe atyre të ju bëjmë një zgjidhje që të mos kemi në të ardhmen probleme qysh ka ndodhur në të kaluarën.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dhanë Ilirik Musliu, drejtor, dhe Valbona Makolli, drejtore.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 45 vota për, u miratua Vendimi për miratimin e Projektregullores për orarin e punës dhe mbrojtjen nga ndotja akustike në sektorin e gastronomisë.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për miratimin e Projektregullores për transparencë.

Lidhur me këtë propozimvendim të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Osman Bllaca. **Berna Saraçi** tha se për të qenë sa më e plotësuar kjo rregullore, duhet të përfshijë në vete transparencën gjuhësore, t’i bashkëngjitet nenit 18, d.m.th. ku trajtohet aspekti i gjuhës dhe specifikohet në mënyrë eksplicite përdorimi i gjuhës zyrtare, specifikisht përdorimi obligativ i gjuhës së shenjave në Komunën e Prishtinës, kudo që të kërkohet përbrenda saj, andaj vlerësojmë që nëse përfshijmë gjuhen e shenjave si gjuhë zyrtare, atëherë në fakt këto nene sipas ligjeve dhe rregulloreve do të jenë më të zbatueshme.

Fiknete Bejta tha se transparencja dhe llogaridhënia janë elementet thelbësore të qeverisjes së mirë në nivelin lokal, dhe si e tillë si objektiv është synuar nga dita e parë nga qeveria e z. Rama. Fusha e transparencës komunale ka një strukturë të mirë të organizuar të rregullave juridike ligjore dhe nënligjore. Nga ky plan veprimi dhe nga kjo rregullore, synohet të arrihet grupimi i përgjegjësive kryesore të Komunës, bazuar në rregullativën juridike, duke pretenduar t’i shërbejë Komunës si dokument kornizë në një periudhë afatgjate. Po ashtu, kjo rregullore ka për qëllim t’i ofrojë publikut qasje të lehtë në mbikëqyrjen dhe zbatimin e

politikave nga organet e Komunës, duke pasur informatë të shpejtë, të dhëna të qasshme, publikim të të gjitha akteve normative që janë me interes për publikun.

Osman Bllaca tha se propozimi i dhënë nga znj. Saraçi do të inkorporohet në këtë rregullore.

Leutrim Retkoceri tha se edhe ne si GP e përkrahim propozimin e dhënë nga znj. Saraçi, mirëpo mendoj se këto propozime duhet t'i nënshtrohen një votimi nga Kuvendi që ato të përfshihen, dhe kjo praktikë të përcillet deri në fund, sepse ashtu e thotë edhe rregullorja.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 42 vota për, u miratua propozimi i znj. Saraçi, që të inkorporohet në Rregulloren për transparencë.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 43 vota për, u miratua Vendimi për miratimin e Rregullores për transparencë.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit për caktimin e komisioneve për rekrutim të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese në kryeqytetin e Republikës së Kosovës, nr.01-151/01-151637/22, dt.30.06.2022.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Besianë Musmurati, drejtore.

Gëzim Sveçla tha se ne nuk do ta votojmë këtë propozimvendim, pasi që ne kemi konstatuar se ka një moskoordinim mes partnerëve të koalicionit.

Ajet Brajshori theksoi se ne si GP i LDK-së, e mbështesim propozimin që Fitnete Tutuli të jetë anëtare e Komisionit për rekrutimin e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në konkurset e ardhshme.

Leutrim Ratkoceri u shpreh në përkrahje të propozimvendimit për miratim dhe i ftoi të gjitha grupet parlamentare që ta miratojnë.

Gëzim Mehmeti tha se personi për të cilin kërkohet që ne ta votojmë e nuk e dimë kush është ky person, a ka mundësi të na e paraqisni CV-në e tij, që t'iu prezantohet anëtareve të Kuvendit.

Lidhur me vërejtjet dhe shqetësimet e ngritura nga parafolësit, sqarime shtesë dhanë Besianë Musmurati, drejtore, dhe Përparim Rama, kryetar.

Kryesuesi konstatoi se më 25 vota për, u miratua Vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit për caktimin e komisioneve për rekrutim të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese në kryeqytetin e Republikës së Kosovës, nr. 01-151/01-151637/22, dt.30.06.2022.

Pika e tetë

Propozimvendimi për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2023.

Për këtë pikë të rendit të ditës, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Doruntinë Maloku, drejtoare.

Nora Kelmendi tha se në këtë material të prezantuar mungojnë pesë certifikata të pronës, për të cilat nuk dihet a janë pronë komunale a nuk janë. Do të duhej treguar se këto parcela: me nr. 16/0, 17/0, është në Zonën kadastrale, Orloviq, nr. 1498/3, në Zonën kadastrale, Prishtinë, nr. 1498/88, në Zonën kadastrale, Prishtinë, si dhe nr. 1499/8, në Zonën kadastrale Prishtinë, nuk i kemi pranuar certifikatat e pronës.

Donjeta Dragusha falënderoi drejtoaren për përgatitjen e listës së veçantë të pronave, të cilat parashihen që potencialisht të jepen në shfrytëzim gjatë vitit të ardhshëm dhe si GP e përkrahim për miratim.

Gëzim Sveçla tha se lista e pronave në këtë formë konsideroi se është dokumentacioni i pa kompletuar. Pse nuk po kompletohet dokumentacioni, kështu nuk mundemi ne me votuar, diçka që nuk është me dispozitat ligjore.

Gëzim Mehmeti u shpreh se unë konsideroj që kjo që po kërkohet për votim është e pakuptimtë. Pse po veprohet kështu, kërkohet nga ne të votojmë diçka për të cilën ne nuk kemi informata?!

Lidhur me vërejtët e ngritura nga parafolësit, sqarime shtesë dhanë Doruntinë Maloku, drejtoare, dhe Donat Lushaku, drejtor.

Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2023.

Pika e nëntë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Arif Dermishit.

Për këtë propozimvendim të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Doruntinë Maloku, drejtoare.

Kryesuesi konstatoi se më 44 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Arif Dermishit.

Pika e dhjetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Shukrije Bajgorës, Muhamed Sadikut, Adnan Sadikut dhe "Vëllezërit Asllani", SHPK.

Lidhur me këtë propozimvendim të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Doruntinë Maloku, drejtoare.

Nora Kelmendi tha se ne si GP i LVV-së, kemi disa paqartësi për këto këmbime, si për çështjen e pronësisë, çështjen e vjetërsisë dhe certifikatave të pronës, si dhe çështjen e shkresës së dërguar nga Drejtoria e Pronës në Drejtorinë e Planifikimit. Ne kemi konstatuar se parcelat kadastrale që na janë prezantuar në këtë formë, nuk mund ta votojmë këtë këmbim të pronave private me prona të cilat nuk janë prona komunale, por edhe për shkak të materialit të pakompletuar.

Jeta Rafuna tha se ne si GP këtë propozimvendim e përkrahim për miratim.

Gëzim Mehmeti tha se kjo formë e këmbimit të pronave është shqetësuese, sepse ka të bëjë me kontestin e çështjes, pronat – parcelat, certifikatat e të cilave nuk janë pronë komunale, e që konsideroi se nuk duhet as të diskutohet më tej, kështu që do të ishte mirë që kjo pikë të tërhiqet nga rendi i ditës.

Petrit Reqica tha se duke pasur parasysh se janë sjellë dokumente gjysmake, ne nuk do t'i votojmë, në secilën pikë që ne po ju kundërshtojmë po kemi arsye, mos na faturoni neve arrogancën e mosdijen tuaj.

Arbër Vokri theksoi se edhe ne si GP kemi votuar vendime të ngjashme, por janë kthyer nga Ministria dhe është anuluar ai vendim. Nuk ndodh asnjëherë për shkak se duhet me qenë i vëmendshëm për mundësinë e konfliktit të interesit, edhe mos me ndërhy as mos me influencuar asnjë vendim që ka të bëjë me Komunën e Prishtinës, edhe asaj iu kam përmbajtur deri tash edhe do t'i përmbahem edhe më tutje.

Gëzim Sveçla tha se duke pasur parasysh mungesën e dokumentacionit, si dhe certifikatat e paafatshme, ndërsa në anën tjetër po na bëni ftësë me e votua, po na fton me shkelur ligjin, nuk po e di pse kjo qasje e juaj kështu, kjo arrogancë dhe me këtë qasje veç po vazhdon avazi i vjetër, me këtë avaz po kthehen lëndët, po vonon zhvillimi.

Triera Kasumi – Berisha, theksoi se insistimi që po bëhet nga ana e juaj që të votohet ky këmbim i pronave, konsideroj se është i papranueshëm edhe në kësi raste, sinqerisht detyrohem me e lëshuar sallën, se nuk mundem me u bë pjesë e një Kuvendi, ku niveli i diskutimit bie në këtë pikë kaq të ulët. Ne disa herë kemi kërkuar që këto çështje me u rregulluar para se të na sillen këtu në Kuvend.

Lidhur me vërejtët dh sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dha Doruntinë Maloku, drejtore.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për dhe 3 kundër, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Shukrije Bajgorës, Muhamed Sadikut, Adnan Sadikut dhe 'Vëllezërit Asllani', SHPK.

Pika e njëmbëdhjetë

Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për ndërtimin e objektit të Odave të Profesionistëve Shëndetësorë.

Për këtë pikë të rendit të ditës të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Doruntinë Maloku, drejtore.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 42 vota për, u miratua Vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për ndërtimin e objektit të Odave të Profesionistëve Shëndetësorë.

Pika e dytëdhjetë

Propozimvendimi për formimin e grupit punës për hartimin e planit vjetorë të punës së Kuvendit për vitin 2023.

Gëzim Sveçla tha se ne si GP kemi qenë pjesë e këtij komisioni gjatë vitit të kaluar, mirëpo ai plan i punës të cilin e voton Kuvendi, në realitet ai fare pak zbatohet, prandaj kësaj radhe ne nuk do të jemi pjesë e këtij grupi punës, nuk do ta propozojmë asnjë anëtarë nga grupi ynë parlamentar.

Kryesuesi konstatoi se më 28 vota për, u miratua Vendimi për formimin e grupit punës për hartimin e planit vjetorë të punës së Kuvendit për vitin 2023.

Pika e trembëdhjetë

Informatë lidhur me Raportin vjetor të komisionit të aksionarëve të NPL "Trafiku Urban", SHA, Prishtinë.

Lidhur me Informatën rreth Raportit vjetor të komisionit të aksionareve të NPL "Trafiku Urban", SHA, Prishtinë, Agron Canolli, në cilësinë e anëtarit të komisionit të aksionarëve të kësaj ndërmarrje, tha se NPL "Trafiku Urban" ushtron veprimtarin e transportit të udhëtarëve në linjat urbane dhe urbane periferike, me qëllim të organizimit të jetës dhe punës së qytetareve, dhe hyn në rangun e veprimtarive tjera shërbyese komunale. Gjatë vitit 2022, ka vepruar me transparencë, raportim të shpenzimeve buxhetore të kryera, evidentim të problemeve dhe marrje të masave konkrete për reduktimin e tyre në funksion të sigurimit, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit. Kjo ndërmarrje si rezultat i rritjes së performancës financiare, ka rritur kapitalin e vet në kuadër të vlerës për investimet e realizuara dhe nga operimet e saj. Kjo ndërmarrje ka një strukturë shumë të madhe financiare të financuar me kredi, ka treguar aftësi financiare për të shlyer detyrimet financiare ndaj kreditorit. Aktualisht, ndërmarrja operon me 51 autobusë, si pjesë e transportit publik në komunën e Prishtinës, që besojmë se gjatë viti 2023 do të zgjerohet edhe me 30 autobusë të ri.

Mirsad Vitija ngriti shqetësim rreth disa dukurive evidente në këtë ndërmarrje, siç janë mënyra e përzgjedhjes së bordit të drejtorëve, konkursi për shpalljen e disa vendeve të lira për pozita të ndryshme, si dhe për marrjen e disa vendimeve të tjera që unë konsideroi se ato vendime nuk qëndrojnë. Konsideroj se ky dokument që na është prezantuar përmban informata të pakta sipërfaqësore dhe shpesh tendencioze, megjithatë pres që vitin e ardhshëm të kemi një raport të detajuar për këtë ndërmarrje dhe të kemi një pasqyrë reale dhe të plotë mbi planet dhe punët e menaxhmentit.

Feim Osamani kërkoi të dijë arsyen pse nuk po lëshohen autobusët e trafikut urban në linjat jo urbane, siç janë fshatrat e Prishtinës deri në fshatin Tenezhdoll, kërkesë që pothuajse e kam parashtruar në çdo mbledhje të Kuvendit, pra kur do ta kenë autobusin banorët e diskriminuar të fshatrave të Prishtinës.

Sami Boroci rekomandoi që në raste tjera kurdo që raportojnë për ndërmarrjet publike lokale, me qenë prezent edhe kryesuesi i bordit edhe kryeshefi, për arsye që me iu përgjigjur pyetjeve që ne mundemi me i shtruar.

Hafiz Krasniqi ngriti një shqetësim rreth gjendjes teknike të autobusëve të linjës 7 B, me ç' rast tha se do të ishte mirë që të bëhen ndryshime në këtë drejtim.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e ngritura nga parafolësit, sqarime dha Agron Canolli, anëtar i komisionit komunal të aksionarëve në NPL Trafiku Urban”.

U konstatua se u përkrah Informata lidhur me raportin vjetor të Komisionit të aksionareve të NPL “Trafiku Urban”, SHA, Prishtinë.

Pika e katërbëdhjetë Informatë rreth mbjelljeve vjeshtore.

Lidhur me Informatën rreth mbjelljeve vjeshtore, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Plator Gërdovci, drejtor.

Feim Osmani tha se ne e kemi parasysh se mbështetja me subvencione në sipërfaqe të mbjella është shumë e rëndësishme dhe ju ndihmon shumë në përballimin financiar shpenzimeve për mbjellje, por i ka edhe anët e saj negative nëse nuk jemi afër bujku në mbështetje tjera. Nëse nuk kemi parasysh fazat e ardhshme, siç është plehërimi me azot në fazën e parë, shkurt – mars të vitit që po vjen, si dhe spërkatja kundër barishteve të këqija, duke u kujdesur që ky proces të bëhet patjetër, dhe që furnizimi me pesticide të jetë i cilësisë së lartë. Nëse të gjitha këto nuk përmbushen në total nga Drejtoria e Bujqësisë, investimi prej 400 mijë euro që është bërë me subvencionimin e mbjelljeve, rrezikon të mbetet vetëm shpenzim, duke mos arritur efektin e paraparë.

U konstatua se u përkrah Informata për mbjelljet vjeshtore.

Pika e pesëmbëdhjetë Informatë nga Drejtoria e Kulturës

Lidhur me Informatën nga Drejtoria e Kulturës, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Arta Balaj, drejtor.

Arianit Beqiri tha se sa i përket aktiviteteve që janë zhvilluar gjatë festave të fundvitit të organizuara nga Drejtoria e Kulturës, konsideroj se nuk është mirë që këto manifestime të koncentrohen vetëm në qendër në sheshe, kështu që në festat e fundvitit shumica e lagjeve nëpër Prishtinë mbesin pa asnjë aktivitet që e dallon ose e shënon festën e Vitit të Ri. Kështu që gjithmonë, duke ia dashur të mirën Prishtinës, forma që e mendojmë ne si grup është që nëse ka data të tilla që Komuna e ka vëmendjen e shtuar për shënimin e tyre, atëherë mendojmë që edhe organizimi duket shumë më i madh.

Elmira Nikqi – Rexha theksoi se festat e fundvitit i kanë shtuar shkëlqim kryeqytetit dhe kanë sjell një atmosferë të gëzueshme në rrugë e sheshe, dekorim, festim i shtrirë në të gjitha sheshet e kryeqytetit, i kanë dhënë një pamje mahnitëse Prishtinës, sot sheshi “Gjorgj Bush”

ofron pamje spektakolare, ku reflektimi i dritave në rrugë dhe bardhësia qiellore përmes qytetit duket brilante, dekorimi tash më është bërë traditë, pra falënderojmë drejtoreshën për të gjitha këto organizime.

Leutrim Retkoceri falënderoi drejtoreshën për të gjitha ato organizime që janë bërë nga Drejtoria e Kulturës për festat e fundvitit, me ç' rast inkurajoi që veprime dhe festivale të tilla të mbani edhe në festa tjera në vazhdimësi, uroj që viti 2023, të jetë një vit i mbarë, me përmbylljen dhe me festimin e Vitit të Ri në kryeqytet, ashtu siç i ka hije.

Sami Boroci tha se është një ndjenjë e mirë kur e sheh një organizim kaq të mirë që po ndodh këto ditë në Prishtinë, sa i përket kësaj përgjizime dhe suksese për një organizim disa ditore që ka dalë të jetë shumë i mirë.

Endrit Zabërgja tha se sa i përket informatës së dhënë nga Drejtoria e Kulturës për organizimin e të gjithave atyre aktivitete të fundvitit, uroj që të krijohet si traditë edhe nga drejtorët e tjerë për evenimente apo projekte të ndryshme.

Petrit Reçica kërkoi të dijë se si është bërë përzgjedhja a atyre artistëve, bendeve të zhanreve të ndryshme, pasi që mendoi se viteve të kaluara ka pasur një laramani shumë më të madhe.

Gresa Lahu, në cilësinë e anëtares së Komitetit për Kulturë, falënderoi drejtoreshën për gjithë atë organizim të aktiviteteve të ndryshme për festat e fundvitit.

Lidhur me vërejtjet e dhëna nga parafolësit, sqarime të nevojshme dha Arta Balaj, drejtore.

U konstatua se u përkrah Informata nga Drejtoria e Kulturës

Pika e gjashtëmbëdhjetë

Pyetje dhe përgjigje

Petrit Reçica, për nënkryetaren e Komunës dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- Ku ka mbetur procesi i Brendimit?
- Shkallët e postës që janë duke u rregulluar atje te "Kurrizi", banorët kanë kërkuar që të rregullohet aty edhe pjerrina për qasjen sa më të lehtë të personave me nevoja të veçanta.

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga z. Reçica, përgjigje dhanë Donjetë Sahatçiu, nënkryetare, dhe Ilirik Musliu, drejtor.

Feim Osmani, për kryetarin e Komunës dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- Rruga magjistrale Podujevë - Prishtinë, sidomos pjesën e cila përshkon fillimin e qytetit të Prishtinës, prej fshatit Bërniceë përgjatë gjithë rrugës "Vëllezërit Fazliu" deri te Xhamia e Llapit, rrugë kjo e cila sot për sot më shumë i përngjanë një zone konflikti e mbushur me pengesa fizike të cilat e shëmtojnë, pengojnë dhe e ngadalësojnë lëvizjen e automjeteve, mbi të gjitha po i shkatërrojnë makinat. Pse nuk i vendosni radarët statikë, të cilët ndëshkojnë ngasësit e padisiplinuar, e që është sipas praktikave forma më e mirë e disiplinimit?

- Pse nuk po lëshohen autobusët e trafikut urban në linjat jo urbane, siç janë fshatrat e Prishtinës, deri në fshatin Tenezhdoll?

Lidhur me pyetjen e parashtruar nga z. Osmani, përgjigje dha Ilirik Musliu, drejtor.

Arbnora Berisha, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave.

- Në rrugën "Selman Berisha", kur do kur do të fillojë të rregullohet ndriçimi publik?
- Kur do të bëhet zgjidhja e problemit të pusetave të ujerave mbledhëse, ato mblidhen nga rruga magjistrale e Bardhoshit e vazhdon deri te udhëkryqi i rrugës magjistrale që del në Milloshevë, në rrugën "Qazim Dragusha".

Lidhur me pyetjen e parashtruar nga znj. Berisha, përgjigje dha Ilirik Musliu, drejtor.

Arbër Vokrri, për nënkryetarin e Komunës:

- Si do ta bëni zgjidhjen e punësimit për disa kategori të punëtorëve, çështjen e punëtorëve të personelit teknik të qendrave të mjekësisë familjare, për higjienistët edhe për punëtorët e sigurimit të shkollave në Komunë.

Lidhur me pyetjen e parashtruar nga z. Vokrri, përgjigje dha Alban Zogaj, nënkryetar.

Gëzim Sveçla, për zyrtarin ligjor të Komunës, për kryetarin e Komunës dhe për drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit:

- Sa vendime janë kthyer për një vit nga MAPL, çka po behet me këto vendime se nuk po i sjellim në seance ashtu siç parashihet në udhëzimin juridik kur kthehet prej MAPL-së?
- A kemi ndonjë vendim për punën e komisionit për pronat e Komunës, konkretisht për banesat, ka kaluar një kohe e gjate që është formuar ky komision, a është ndërmarrë ndonjë veprim?
- A ka ndonjë raport përfundimtarë lidhur me projektin e parkingut nëntokësor, siç e parasheh Ligji për prokurimin publik, dhe a mund të na tregoni se a ka devijime nga projekti fillestar?
- Në kulmin e një ndërtese në lagjen "Aktashi", aty një banor i ka rimodeluar oxhaqet e banesës, duke i bërë të njëjtit jo funksional dhe duke i shkaktuar vështirësi banoreve rezidentë, që edhe përkundër një vendimi për rrënimin e tij gjendja është e pa ndryshuar;
- Më 23 nëntor 2022, në Drejtorinë e Inspeksionit e kamë përcjellë një njoftim përmes emailit, lidhur shqetësimin e një grupi të banorëve të lagjes "Dardania", e që ka të bëjë me uzurpimin e hapësirave publike, dhe nuk është ndërmarrë asnjë hap për rregullimin e gjendjes;
- Sa është numri i punëtorëve me aftësi të kufizuara që punojnë në Komunën e Prishtinës dhe sa në ndërmarrjet publike lokale?

Lidhur me pyetjet e parashtruar nga z. Sveçla, përgjigje dhanë Përparim Rama, kryetar Donjeta Sahatçiu, nënkryetare dhe Florian Dushi, drejtor.

Faqe 16 nga 18

Rashit Gashi, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- Është kërkesë në vazhdimësi e banorëve në zonën e Gollakut, që me ua mundësua edhe atyre sikurse transporti publik që është në komunën e Prishtinës në zonën urbane nëpër qytet, me pasur autobusë komod. Kështu që nëse nuk ka mundësi vitin e ardhshëm me ata 30 autobusë, nëse nuk vijnë gjatë vitit të ardhshëm, është mirë që t'u krijohet një mundësi linjave të transportit privat, që të kenë autobusë sa më komod, dhe të mos anashkalohe mi zona rurale, në këtë rast me zonën qendër. Kjo është një kërkesë e kamotshme, e cila po na përsëritet, dhe po kemi kërkesa të vazhdueshme çdo muaj, sa herë po kemi seanca prej banorëve nëpër fshatra të caktuara;
- Mbyllja e rrugës "Gjorgj Bush", ka shkaktuar tollovi të madhe në komunikacion. Kërkoj që të merren masa që të lirohen të paktën rrugët e tjera për qarkullim, siç janë rrugët njëkahore, si p.sh. janë rrugët: "Kosta Navakoviç" dhe "Garibaldi".

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga z. Gashi, përgjigje dha Përparim Rama, kryetar.

Besart Krasniqi, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave dhe për drejtorin Drejtorisë së Shëndetësisë:

- Banorët e fshatit Sharban kërkojnë që të bëhet ndërtimi i një ure afër xhamisë, sepse në momentin që ka reshje shiu ajo pjesë është e pakalueshme, si dhe kërkojnë të bëhet shtrirja e rrjetit të kanalizimit dhe ujësjellësit;
- Po ashtu, këta banorë ankohen që ka mungesë të mjekëve në QMF që është në fshatin Sharban. Kërkoj që kjo ankesë e tyre të merret në konsideratë.

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga z. Krasniqi, përgjigje dha Përparim Rama, kryetar.

Triera Kasumi-Berisha, për kryetarin e Komunës dhe për drejtorin e Drejtorisë së Administratës:

- Dua ta di se çfarë mekanizmi ka ngritur Komuna dhe zyra juaj për gjithë ato projekte që kanë qenë të projektuara më herët, prej mandateve të kaluara të cilat nuk janë realizuara. Sipas disa informacioneve të ndryshme, kam dëgjuar që kemi projekte të ndryshme nëpër sirtarë të ndryshëm, të cilat janë projekte shumë të mira, por që veç kanë mbetur kështu pjesë e arkivit.
- A është bërë ndonjë analizë prej jush për këto projekte, të cilat edhe ndoshta kanë përfunduar edhe me pagesa, dhe a kanë me u zbatuar ndonjëherë ose a kanë me u shqyrtuar nga ana juaj?
- Në Drejtorinë e Administratës kam bërë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, 3 nga ato kërkesa të cilat e kanë tejkaluar afatin edhe skam marrë përgjigje, përveç njëres që është në Drejtorinë e Pronës. Unë përgjigjen me shkrim ende nuk e kam marrë ashtu siç e kam kërkuar, e cila ka qenë në lidhje me kompaninë e cila është kontraktuar për përfaqësimin ligjor të Komunës.

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga znj. Kasumi-Berisha, përgjigje dha Përparim Rama, kryetar.

Ermal Osmani, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publik, dhe për kryetarin e Komunës:

- Është kërkesë e banorëve në lagjen "Bregu i Diellit", hapësira mbi ambulancë, e cila është e pashfrytëzueshme, aty është Strehimorja e vjetër afër rrugës "Mehmet Gradica", ku është një hapësirë të cilës i mungon ndriçimi, i mungon këndi i lodrave për fëmijë, i mungon fusha sportive dhe është bërë strehimore për qentë endacakë që i rrezikojnë nxënësit e shkollës "Ismail Qemali". Do të ishte mirë që të merren masa për rregullimin e asaj hapësire, sidomos më urgjente është ndriçimi i saj;
- Është kërkesë e disa të rinjve dhe të rejave të cilët kanë vullnet e pasion për me e zhvillua një sport të rrezikshëm dhe ekstrem, të cilët kërkojnë një vend për krijimin e një Skateparki, kudo në Prishtinë, një vend ku ata ushtrojnë dhe nuk e rrezikojnë qytetarin.

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga z. Osmani, përgjigje dhanë Përparim Rama, kryetar dhe Mimoza Sylejmani, drejtore.

Radije Hoxhaj, për kryetarin e Komunës:

- Ka më se dy vjet e gjysmë që një rrugë e mban emrin "Mak Dizdari", konsideroj se këtu mund të jetë një gabim teknik, andaj kërkoj që emri i rrugës të përmirësohet dhe të shkruhet "Mark Dizdari".

Feim Osmani, për kryetarin e Komunës dhe për drejtorin e Drejtorisë së Inspektionit

- Është shqetësim i banorëve të fshatrave Besi, Rimanishtë, Vranidoll, Teneshdoll, Sharban, Lebanë, lidhur me dukurinë e prerjes ilegale të pyjeve që ka kaluar çdo limit, njësoj siç ka kaluar çdo limit edhe mosinteresimi i Inspektoriatit të Pyjeve për parandalimin e kësaj dukurie negative. Edhe një herë kërkoj që Drejtoria e Inspeksionit të intervenojë me urgjencë në këtë drejtim, me qëllim që të shpëtojë pyjet nga degradimi, e po ashtu edhe të parandalojë më të keqën që mund të ndodhë në mes të palëve, që në këtë rast janë prerësit ilegale të pyjeve dhe pronarët legjitim të tyre, të cilët po dëmtohet nga prerësit ilegale.

Mbledhja përfundoi në orën 17:00.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Fehmi Kupa



Faqe 18 nga 18